

UDHËZIM
Nr. 7, datë 6.2.2013

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 “Për TVSH-në”, të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Pas pikës 20.3 shtohet pika 20.4 me këtë përmbajtje:

“20.4 Në rastet e zbatimit të marrëveshjeve kuadër për bashkëpunim dhe zhvillim, në bazë të të cilave përfitues janë institucionet buxhetore, të cilave në momentin e importimit nuk iu janë lëvruar nga Drejtoria e Thesarit fondet buxhetore për pagimin e TVSH-së për importimin e mallrave të përfituara në kuadër të këtyre projekteve, administrata doganore procedon me shtyrje të pagesës së TVSH-së në momentin e importit, për një periudhë deri në tre muaj, me kusht që institucioni buxhetor përfitues të paraqesë:

a) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave - kopje të kontratës së lidhur midis institucionit buxhetor përfitues dhe donatorit;

b) pranë degës doganore që do të akordojë shtyrjen e TVSH-së, - urdhrin e pagesës të vulosur nga dega e thesarit përkatës.

Në qoftë se nuk kryhet pagesa brenda periudhës 3-mujore, njoftohet Ministria e Financave.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode